



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenas/Glllogoc
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060/01-45717 dt. 16/09/2024

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Anetarja më e vjetër e KPF-së, me dt. **20.9.2024** (E Premte) duke filluar në ora 11:00, në sallën e Bordit të Drejtorëve të Komunës.

THËRRET
Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 16.9.2024 për dëgjimin e përgjithshëm buxhetor për draft buxhetin e vitit 2025 dhe projeksionet për vitet 2026-2027.
2. Propozim vendim për Financimin e projektit.
3. Propozim vendim për aprovimin e Planit të punës për Ekipin Komunal për të drejtat e Fëmijës, Drenas (2024-2027)
4. Të ndryshme.

Drenas, 16.9.2024



Anëtarja më e vjetër e KPF-së

Azëmjine Bujupi-Gjoka



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas – Municipality of Drenas
Kuvendi Komunal



PROCES VERBALE
I
DËGJIMIT BUXHETOR

REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
APRIL 16/09/2024			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
02	060/01	45713	

Datë: 16.09.2024
Ora: 10:00
Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Dëgjimi publik i thirrur nga Komiteti për Politikë dhe Financa kishte si të ftuar qytetarët e Komunës së Drenasit dhe administratorët e vendbanimeve. Ky dëgjim kishte për objekt shqyrtimin e buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026-2027. Në takim ishin të pranishëm:

Ramiz Lladrovci	Kryetar i Komunës së Drenasit
Albulena Saliuku	Drejtoreshë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
Kushtrim Bajraktari	Zyrtar Kryesor Financiar
Azemine Gjoka	Asambleste e Kuvendit Komunal,
Bekim Dobra	Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun

Dëgjimin e hapi Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, **i cili iu drejtua të pranishmëve me fjalët si vijon:** I nderuari, Kryetar i Komunës së Drenasit, z. Ramiz Lladrovci, drejtor të drejtorive komunale, anëtar të Kuvendit të Komunës, administrator të fshatrave, qytetar.

Jemi mbledhur sot në këtë dëgjim buxhetor për të diskutuar planifikimin e buxhetit për vitin 2025 dhe projeksionet për vitet 2026-2027.

Kalendari i dëgjimeve buxhetore është përgatitur me kohë, sipas afateve ligjore dhe është publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës, në platformën e konsultimeve publike në rrjetin social të facebook-ut si dhe janë kontaktuar të gjitha grupet e nen përfaqësuar për të qenë pjesë e këtij dëgjimi buxhetor. Komuna e Drenasit ka të hartuar edhe data bazën e të dhënave, ku është shfrytëzuar për të marr pjesë të gjitha grupet e interesuara.

Komuna me kohë ka bërë njoftimin dhe ftesën. Që nga muaji Maj i këtij viti, pasi që kemi pranuar Qarkoren Buxhetore, kemi ftuar ekspertet, OJQ-të, Shoqërinë Civile dhe profesionistët për të kontribuar në hartimin e këtij dokumenti.

Ky dokument është përgatitur në bazë të Qarkores Buxhetore të lëshuar nga Ministria e Financave, e cila paraqet përmbledhjen e kërkesave fillestare të planifikimit e parashikimit për vitin 2024 dhe projektionit të buxhetit për vitet 2025-2026.

Komuna e Drenasit shquhet për transparencë e llogaridhënie, ndaj me kohë këto dy dokumente, Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026 dhe draft-Listën e Investimeve kapitale i ka publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Ndjej për obligim të ju njoftoj me rregullat e takimit, që diskutimet për buxhet të jenë reciproke me qëllim që të behët një përmbledhje me interes për të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit. Pra, karakteri i këtij dëgjimi është që të jepni propozime, sugjerime dhe të diskutoni për planifikim të buxhetit për vitin e ardhshëm, por jo të jepni komente për projektet e këtij viti, ose viteve paraqake, sepse janë takime të tjera ato, kur qytetarët kanë mundësi të komentojnë projektet aktuale.

Para vetës keni dy materiale, draft-listën e investimeve kapitale si dhe informatën se si është planifikuar të adresohet buxheti komunal për vitet në vazhdim.

Fjalën e mori, **Azmine Gjoka**, si anëtare më e vjetër e Komitetit për Politikë dhe Financa në mungesë të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, e cila njoftoi se Komuna e Drenasit ka përgatitur me kohë këto dy dokumente, Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore Komuna e Drenasit shquhet për transparencë e llogaridhënie, ndaj me kohë këto dy dokumente, Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026 dhe draft-Listën e Investimeve kapitale i ka publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës, dhe draft-Listën e Investimeve kapitale i ka publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës. Të nderuar të pranishëm tani fjala është për ju, por paraprakisht ju kisha lut që kur të merrni fjalën, të prezantoheni për arsye të regjistrimeve dhe mbajtjes së procesit të takimit.

Kadri Ajazi-Administrator i fshatit Sankoc, Fushticë e Ultë dhe Fushticë e Epërme kërkojmë asfaltimin e disa rrugëve, si: Isufi dhe Ajazi, Lika, Rama dhe disa rrugica po ashtu kemi probleme me ujë të pijes sepse rrjeti nuk mirëmbahet nga kompania e ujësjellësit.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës-pati përgjigjeje për çështjet e parashtruara theksoi që rrugët dhe trotualet do të shtrohet aty ku prona është publike ose prona private i dhurohet Komunës, ndërsa për ujë dhe mbeturina Komuna nuk është përgjegjëse, sepse janë kompanitë e caktuara që i menaxhojnë.

Bjaram Qallapeku -Administrator i fshatit Tërstenik I-II fshati ka kërkesë për trotuar kanalizim si dhe disa rrugica të pa asfaltuara, ndriçim dhe uji i pijes.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës-pati përgjigjeje për çështjet e parashtruara theksoi që rrugët dhe trotualet do të shtrohet aty ku prona është publike ose prona private i dhurohet Komunës, ndërsa për ujë dhe mbeturina Komuna nuk është përgjegjëse, sepse janë kompanitë e caktuara që i menaxhojnë.

Semedin Kiqina, Administrator i fshatit Baicë: Kërkoj që kanalizimi i ujërave të zeza të rregullohet, ndriçimi publik, dhe deponimin e mbeturinave

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Sa i përket kanalizimeve të ujërave të zeza nuk ka fshat në Komunën e Drenasit që kemi punuar më shumë se në fshatin Baicë, sa i përket ndriçimit jemi në proces të përfundimit ndërsa sa i përket rrugica po kemi pengesa nga qytetarët në prona private.

Xhafer Dobërdelani, Administrator i fshatit Korroticë e Lartë, Zabel i Lartë- kërkoj përfundimin e dy rrugicave që kanë filluar të punojnë si dhe rregullojnë kanalizimin dhe ujësjellësin.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Këto kërkesa, tashme i kemi diskutuar ne dëgjimin buxhetor te mbajtur në muajin korrik. Dhe sigurisht se janë duke u shqyrtuar.

Florentina Elezi-Veliu, Asambliste: Ne si LVV kemi bërë një propozim për subvencionim për lehonat i cili ka qenë shumë i suksesshëm për vitin 2024 mirëpo a do të vazhdoj edhe për vitin 2025? Dhe kërkesa tjetër është për me i subvencionua familjet me kushte jo të mira ekonomike që i dërgojnë fëmijët në kopshte private në këtë formë me ia lehtësua grave në tregun e punës, e kemi bërë si kërkesë mirëpo kjo nuk është aprovuar çka ka ndodh me këtë kërkesë?

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Sa i përket subvencionimit të lehonave, qeveria është duke u marrë me këto subvencionime dhe sigurisht se do të ketë edhe vitin tjetër. Tutje, Komuna e Drenasit ashtu sikur këtë vit edhe për vitin 2025 ka nda mjete buxhetore për te subvencionuar nenat lehona ne shumen prej 100 euro. Ndërsa për subvencionim të çerdheve (familjeve që i dërgojnë fëmijët në çerdhet private), së pari ata duhet të paraqesin kërkesë pranë komunës e më pas do ti shqyrtojmë ato dhe ta shohim se kush i plotëson kriteret sipas mundësive buxhetore.

Zekë Kluna, Administrator i fshatit Poklek i Ri dhe i Vjetër dhe Vasilevë: Në Poklek të Vjetër kërkojmë furnizimin me ujë të pijes, ndriçimin i rrugëve në Poklek dhe Vasilevë, firmat që i kanë kryer disa punime në rrugë gypat janë prish tek shkolla në Poklek dhe te lumi "Drenica". Një gropë septike me e mbyll kërkoj me marrë masa sa i përket kësaj çështje. Dhe kërkesë tjetër rregullimi i një parku të vogël tek ujit i thartë. Ndërtimi i një fushe sportive tek Banesat e reja në Poklek të Ri.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Këto kërkesa, tashme i kemi diskutuar ne dëgjimin buxhetor te mbajtur në muajin korrik. Dhe sigurisht se janë duke u shqyrtuar.

Meqë nuk pati diskutime të tjera, kryesuesi e konsideroi të mbyllur dëgjimin buxhetor. Dëgjimi buxhetor përfundoi në orën 11:50.

Procesmbajtëse:

Fakete Hoti



Udhëheqëse për punë të Kuvendit të komunës

Donë Fejza Ajazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Drenas (Glllogocit)
Kuvendi Komunal



01- Nr - 400/01-45716 dt. 16/09/2024

Në veshtrim të nenit 58, paragrafi 1, nën-paragrafi h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34, pika 6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 Nr. 320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Rregullores MF-NR 04/2017 mbi Kritret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe Rregulloren 02-400/01-18380 për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores për Ndarjen e subvencioneve, vendimit 01 Nr.400/01-26131, të dt. 03.06.2024, si dhe buxhetit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2024, me propozim të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

**PROPOZIM VENDIM
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT**

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin “Shërbime të avancuara rehabilituese dhe trajtim gjithëpërfshirës social për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara”, të Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “Handikos”, lidhur me mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e aktiviteteve për vitin 2024.

Neni 2

Projekti i Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”- “Ofrimi i Shërbime Sociale dhe rehabilituese sipas standardeve për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara”, përkrahet në shumën prej 5.000 € (pesë mijë euro), mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2024.

Neni 3

Financimi- Subvencionimi i projektit do të bëhet nga kategoria ekonomike e shpenzimeve subvencione dhe transfere/ kodi ekonomik 21/611/73010/21200/0760 të parapara me Buxhetin për vitin 2024 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.

Neni 4

Mjetet financiare barten në konton e Shoqatës së Presonave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozimvendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga OJQ “HANDIKOS”, që të bëjë raport narrativ-me shkrim dhe financiar përmes zyrtarit monitorues në mënyrë që të njoftojë DSHMS-në për mënyrën e shpenzimit të mjeteve.

Neni 5

Ky propozim vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit Komunal të Drenasit dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.



KRYETARI I KOMUNËS

Ramir Lladrovci

Arsyetimi

Bazuar në nenin 16 paragrafi 3, të Rregullorës MF-NR. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Rregullores Nr. 12/320-19338, të dt. 07.04.2017 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, është formuar komisioni me Vendimin Nr. 01-400-01/12756 i datës 03.06.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike Nr.06-400/01-26133, të dt. 03.06.2024, të shpallur nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2024.

Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar aplikacionet e aplikantëve për subvencionim të OJQ-ve në bazë të thirrjes publike të lartëcekur, ku gjithsej kishin aplikuar gjashtë (6) OJQ:

Pas hapjes së zarfeve të OJQ-ve aplikuese, komisioni ka verifikuar dokumentacionet e dorëzuara të 6 organizatave aplikuese, si përfitues përcakton për mbështetje financiare Shoqatën e Përsoneve me Aftësi të Kufizuara "HANDIKOS" Drenas.

Meqë vlera e përkrahjes financiare në bazë të thirrjes publike është 5.000 €, kjo shumë do t'i ndahet kësaj OJQ-je, financimi- subvencionimi i projektit do të bëhet nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere/ kodi ekonomik 21/611/73010/21200/0760 të paraparë me Buxhetin për vitin 2024 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
ZYRA E KRYETARIT



Nr. 01-420/01-45715 dt. 16/09/2024

Në vështrim të nenit 58 par.1 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: Që në vështrim të nenit 40 pika 40.2 të ligjit për vetëqeverisje Lokale, Vendimi Nr.01-030/01-17622 dt.13.04.2023, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e rregullt më datë _____ vitit 2024, aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për Aprovimin e Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Drenas

(2024 – 2027)

Neni 1

APROVOHET Plani i Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Drenas, hartuar nga Grupi Punues Komunal.

Neni 2

Programi ka për qëllim përcaktimin e masave për realizimin e të drejtave, përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve, eliminimin e punëve të rënda për fëmijë, si dhe përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësisë të subjekteve për mbrojtjen e fëmijëve, duke i përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta në Komunën e Drenasit.

Neni 3

Pas aprovimit të këtij propozim vendimi në Kuvendin e Komunës, për zbatimin e tij do të përkujdeset Kryetari i Komunës, dhe Drejtoratet përkatëse të Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky Propozim Vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës, dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga MAPL-ja, Prishtinë.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

Arsyetim

Më Udhëzimin Administrativ Nr.06/2012 për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, Kryetari i Komunës së Drenasit ka themeluar Ekipen për të Drejtat e Fëmijës me Vendimin Nr 01-030/01-17622 dt.13.01.2024 , ekip ky i cili pas takimeve dhe punëtorive të ndryshme, ka hartuar Planin e Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës (2024 – 2027) në mënyrë që të definoj prioritetet e Komunës dhe masat e nevojshme që duhet ndërmarrë në vazhdimësi për përmirësimin e situatës në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Gjithashtu hartimi i këtij plani do të mundësoj parandalimin në përfshirjen e fëmijës në dukuri të mundshme negative dhe do të mundësoj ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për të realizuar të drejtat dhe sigurimin e mbrojtjes së fëmijës në pajtim me legjislacionin në fuqi.